



12

KONTRATE SHITJEJE KUOTASH

Ne Tirane, sot, me date 11.12.2015, perpara meje, Ridvana Ruçi, Noter prane Dhomes se Notereve Tirane, me seli ne rr. Kajo Karafilii, Tirane u paraqiten personalisht palet e meposhteme:

Znj. Mynevere Hasanaj, shtetase shqiptar,e bija e Ramadan-it, lindur ne Kucove Berat me 29.01.1956 banues ne Tirane, Rr.Sami Frasheri, pall. Triss Ndertim mbajtes i kartes se ID me nr. 029127364, dhe nr. personal F65129005Cne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise "Kolegji The Independent" sh.p.k.

(qe ketu e me poshte do te quhet "SHITESI") dhe,

Z. Besnik Hasanaj, shtetas shqiptar, Reshat-it, vendlindja Bajram Curri, i datelindjes 25.12.1954, banues ne Tirane, me adrese Rruga Sami Frasheri, Pallati TRISS, Shk. A, Kati 10, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin me numer 030989148 dhe numer personal F41225154I

(qe ketu e me poshte do te quhet "BLERESI").

Pasi konstatova statusin juridik te paleve, te dy madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, me vullnetin e tyre te lire dhe te plote ata kerkuan dhe rane dakord per hartimin e kesaj Kontrate Shitjeje Kuotash duke u mbeshtetur ne parashikimet e Kodit Civil te Republikes se Shqiperise sipas percaktimeve qe vijojne me poshte:

Duke qene se ekzistojne keto kushte paraprake

- Rezulton se Shoqeria " Kolegji The Independent " sh.p.k. eshte person juridik shqiptar, i regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me nr. NIPT K42725403F, date 16.07.1999. Shoqeria ka si ortak te vetem te saj znj. Mynevere Hasanaj e cila zoteron 100% te kapitalit;
- Znj. Mynevere Hasanaj deshiron te shese 100 perqind te kuotave te shoqerise "Kolegji The Independent" sh.p.k. dhe Z.Besnik Hasanaj deshiron te bleje keto kuota te kapitalit te shoqerise;
- Ne daten 13.12.2015 Ortaku i Vetem te Shoqerise " Kolegji The Independent " sh.p.k. ka marre vendimin per shitjen e 100% te kapitalit tek Z. Besnik Hasanaj.

Palet e mesiperme kane rene dakort te lidhin kontraten si me poshte vijon

Neni 1 Objekti i Kontrates

- Objekti i kesaj Kontrate eshte transferimi i pronesise se 100% te kapitalit qe zoteron Shitesi ne shoqerine " Kolegji The Independent " sh.p.k. tek Bleresi sipas te gjithe termave dhe kushteve te parashikuara ne kete kontrate.

Neni 2
Cmimi i shitblerjes dhe menyra e pageses

- 2.1 Palet bien dakord qe cmimi total i shitblerjes se ketyre kuotave do te jete 100.000 leke
- 2.2 Pagesa e kesaj shume eshte kryer jashte zyres se noterise me para ne dore dhe palet deklarojne se nuk kane asnje detyrim te pashlyer ndaj njeri tjetertit ne lidhje me pagesen e cmimit te shitblerjes sipas kesaj kontrate.

Neni 3
Kalimi i pronesisë

- 3.1 Palet bien plotesisht dakort qe pronesia mbi keto kuota nga Shitesi tek Bleresi kalon me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe se Shitesi zhvishet nga cdo e drejte qe lidhet me pronesine e tij mbi kuotat ne favor te Bleresit.
- 3.2 Nje kopje e kesaj kontrate shitjeje do te depozitohet menjehere prane QKR, ne menyre qe te behet publikimi i transferimit te pronesisë per efekt te te treteve.

Neni 4
Te drejtat dhe detyrimet e paleve

- 4.1 Shitesi merr persiper, garanton dhe siguron Bleresin se deri ne momentin e lidhjes dhe te nenshkrimit te Kontrates se mesiperme keto kuota dhe shoqeria:
- Nuk jane objekt dhe/ose subjekt i ndonje konflikti gjyqesor;
 - Shitesi eshte pronar ligjor dhe nuk ka persona te tjere te kene pretendime ne lidhje me keto kuota;
 - Dokumentacioni i bashkengjitur kesaj Kontrate, eshte original, ligjor dhe nuk eshte marre ne rruge te kundraligjshme apo i fallsifikuar;
 - Shitesi ka shlyer te gjitha detyrimet fiskale dhe ligjore qe lidhen me te drejten e pronesisë mbi kuotat dhe aktivitetin e shoqerise;
 - Nuk ka asnje kontrate te lidhur me pare e cila te kete ndikim te drejteperdrejte mbi pronesine mbi keto kuota.
- 4.2 Shitesi eshte i detyruar te paguaje detyrimet ne shoqeri dhe ndaj shtetit deri ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate shitjeje. Pas ketij momenti detyrimet e tjera qe lidhen me titullin e pronesisë mbi kuotat do te perballohen nga Bleresi. Shpenzimet e tjera behen nga palet sipas parashikimeve te KC.
- 4.3 Per pagesen e cdo shpenzimi shtese qe lidhet me realizimin e puneve pergatitore per realizimin dhe e objektit te aktivitetit te shoqerise, palet do te bien dakort sipas parashikimeve te statutit te shoqerise.
- 4.4 Qe nga momenti i nenshkrimit te kesaj Kontrate, Bleresi paguan cdo lloj takse mbi kapitalin qe ai zoteron ne shoqeri, detyrimet ndaj te treteve, shtetit, etj.
- 4.5 Bleresi ka te drejte qe te sillet mbi keto kuota nga momenti i nenshkrimit te kesaj kontrate si pronar i ligjshem.
- 4.6 Kjo kontrate eshte e detyrueshme edhe per trashegimtarët, pasardhesit ne detyre, etj. te paleve.



Neni 6 Zgjidhja e Kontrates

- 6.1 Palet nuk mund ta zgjidhin kontraten ne menyre te njeanshme pervec kur kemi mos permbushje te detyrimeve kontraktuale.
- 6.2 Asnjera nga palet nuk ka te drejte te beje ndryshime ne Kontrate ne menyre te njeanshme. Per cdo problem qe mund te lindë, apo ndryshim i domosdoshem i kontrates i diktuar nga kushtet konkrete te vendit apo legjislacionit, palet do te informojne njeri tjetrin ne adresat perkatese me shkrim dhe vetem pasi kane rene dakord mund te realizojne ndryshime ne kontrate.

Neni 7 Interpretimi i Kontrates ne teresi

Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë.

Neni 8 Legjislacioni i zbatueshem dhe juridiksioni

- 8.1 Kjo Kontrate shitblerjeje, eshte hartuar ne baze te legjislacionit shqiptar dhe konkretisht te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.
- 8.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj Kontrate, janë objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykatës se Shkalles se Pare Tirane.

Neni 9 Njoftimet

Çdo njoftim, kërkesë apo çdo lloj komunikimi ndërmjet palëve do të bëhet me shkrim ne adresat e treguara ne kete Kontrate duke pasur parasysh që të dërgohet sa më pare qe te jete e mundur.

Une, Noteri, pasi ua lexova me ze te larte Paleve kete Kontrate, dhe u sigurova per identitetin e tyre, konstatova se ata e gjejne ate te rregullt ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe Une i vertetoj nenshkrimet e tyre sipas ligjit.

SHITESI
ZNJ. MYNEVERE HASANAJ

Mynevere Hasanaaj
Hasanaaj

NOTERI PUBLIK

[Signature]

BLERESI
Z. BESNIK HASANAJ

Besnik Hasanaaj
Hasanaaj

VENDIM I ORTAKUT TE VETEM
TE SHOQERISE "Kolegji The Independent" SH.P.K.

Sot, me date 05.12.2015 ne seline e shoqerise "Kolegji The Independent" Sh.p.k. u mbajt mbledhja e Ortakut te Vetem te shoqerise.

Shoqeria "Kolegji The Independent" Sh.p.k., eshte person juridik shqiptar rregjistruar ne Rregjistrin e Shoqerive Tregtare me vendim nr. 21672 date 16.07.1999 te Gjykates Rrethit Gjyqesor Tirane.

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte:

1. Zhvillimi i veprimtarise arsimore ne nje institucion arsimor privat niveli 8 vjecar e i mesem.

Ne mbledhje merr pjese Ortaku i Vetem si me poshte:

1. **Znj. Mynevere Hasanaj**, shtetase shqiptar,e bija e Ramadan-it, lindur ne Kucove Berat me 29.01.1956 banues ne Tirane, Rr.Sami Frasherit, pall. Triss Ndertim mbajtes i kartes se ID me nr. 029127364, dhe nr. personal F65129005Cne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise "Kolegji The Independent" sh.p.k., e cila zoteron 100% te kuotave te shoqerise.

Rendi i Dites si me poshte:

- Shitja e 100% e pjesmarrjes se Znj.Mynevere Hasanaj ne shoqerine "Kolegji The Independent" Sh.p.k.

Ortaku i Vetem i Shoqerise pasi diskutoi ne lidhje me te gjitha ceshtjet e mesiperme, me vullnetin e tij te lire:

VENDOSI:

1. Shitja e 100% e pjesmarrjes se Znj.Mynevere Hasanaj ne shoqerine "Kolegji The Independent" Sh.p.k.

Duke mos patur ceshtje tjeter per te diskutuar, mbledhja deklarohet e mbyllur

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

Znj. Mynevere Hasanaj

Mynevere Hasanaj
Hasanaj